

DOCUMENT RESUME

ED 176 577

FL 010 648

**TITLE** Albanian: Basic Course. Volume X, Lessons 111-120.  
**INSTITUTION** Defense Language Inst., Monterey, Calif.  
**PUB DATE** Apr 70  
**NOTE** 82p., For related documents, see FL 010 626-628, FL 010 634, and FL 010 637-648  
**AVAILABLE FROM** Defense Language Institute, Foreign Language Center, Nonresident Instruction Division, Presidio of Monterey, California 93940  
**LANGUAGE** Albanian; English

**EDRS PRICE** MF01/PC04 Plus Postage.  
**DESCRIPTORS** Adult Education; \*Albanian; \*Audiolingual Methods; Classroom Materials; Idioms; \*Instructional Materials; \*Language Instruction; Military Science; Postsecondary Education; Reading Materials; \*Second Language Learning; Speech Communication; Uncommonly Taught Languages; \*Vocabulary

**ABSTRACT** This last of ten volumes of audiolingual classroom instruction in Albanian for adult students contains 10 lessons, each consisting of a prose narrative, a set of questions, and a glossary of new vocabulary items and idioms. Military terminology is emphasized. (JB)

\*\*\*\*\*  
 \* Reproductions supplied by EDRS are the best that can be made \*  
 \* from the original document. \*  
 \*\*\*\*\*

# ALBANIAN

## BASIC COURSE VOLUME X LESSONS 111-120

ED176577

U.S. DEPARTMENT OF HEALTH  
EDUCATION & WELFARE  
NATIONAL INSTITUTE OF  
EDUCATION

THIS DOCUMENT HAS BEEN REPRODUCED EXACTLY AS RECEIVED FROM THE PERSON OR ORGANIZATION ORIGINATING IT. POINTS OF VIEW OR OPINIONS STATED HEREIN DO NOT NECESSARILY REPRESENT THE NATIONAL INSTITUTE OF EDUCATION.


PERMISSION TO REPRODUCE THIS MATERIAL HAS BEEN GRANTED BY

ERIC

ON BEHALF OF THE

EDUCATIONAL RESOURCES INFORMATION CENTER (ERIC)

APRIL, 1970




F2010648

# DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

## DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

This publication is for use by the faculty, staff, and students of the Defense Language Institute as a part of the Defense Language Program. Inquiries concerning these materials, including requests for copies or authority to reproduce materials contained herein should be addressed to Director, Defense Language Institute, Washington Navy Yard (Anacostia Annex), Washington, D. C. 20390.

  
JAMES R. KOENIG  
Colonel, USA  
Director

## PREFACE

This volume is the text for a part of each of ten daily lesson cycles of the last weeks of the Intermediate Phase, usually the 30th and 31st week. Its purpose is to present specialized Air Force terminology in a variety of different contexts, especially in regard to radio communication.

Each lesson consists of a prose narrative, a set of questions, and a glossary of new vocabulary items and idioms. The more specialized terminology of the narrative is briefly introduced in class, whereupon the student studies the narrative itself at home, until he is able to answer the questions on it in class on the following day. The ultimate objectives are mastery of the terminology and the ready use of it in free conversation.

For a suggested accommodation of the material in the daily lesson cycle see the Program of Instruction.

Inquiries concerning these materials, including requests for authorization to reproduce all or part of them, should be addressed to the Director, Defense Language Institute, U.S. Naval Station, Anacostia Annex, Washington, D.C. 20390.

## TABLE OF CONTENTS

<u>Lesson</u>	<u>Page</u>
111 TWO AIRPLANES ON AN INTERCEPTING SEARCH--1	1
112 TWO AIRPLANES ON AN INTERCEPTING SEARCH--2	9
113 SAVING THE LIFE OF A PATIENT--1	17
114 SAVING THE LIFE OF A PATIENT--2	25
115 FLIGHT TRAINING WITH A STUDENT PILOT	33
116 MODERN ANTI-AIRCRAFT DEFENSE	41
117 THE IMPORTANCE OF THE PARATROOPERS	49
118 INVESTIGATING AN AIRPLANE ACCIDENT	57
119 A DANGEROUS AIRCRAFT LANDING	65
120 AN EVENING AT A MILITARY SEAPORT	75

Mësimi i 111-të

## ÇIFTI ROJE NË KAPJE

### Pjesa e parë

Nëntoger Niko Baftjari sapo ka kryer akademinë e aviacionit. Ai është tani pilot ndjekës dhe si i tillë duhet t'i vazhdojë stërvitjet edhe për një vit tjetër, për të pasur njohuri më të mira pilotazhi dhe për të zbatuar më mirë detyrat luftarake. Detyrat e fluturimit janë të koklavitura. Sot do të ju tregoj një nga këto stërvitje me karakter mësimor.

U-zbulua një objekt ajror armik. Në dhomën e pilotëve, të cilët qëndronin në gadishmërinë numër dy, u-dëgjua sinjali i alarmit luftarak. Menjëherë pas këtij sinjali kumboi zëri i telefonistit të repartit:

"Në njëshin!"

"Kuptuam. Në njëshin!" u-përgjigj piloti Niko Baftjari dhe vrapoi drejt reaktivit të tij. Pas tij vinte Selman Zagari, një pilot tjetër i ri. Të dy pilotët hynë në kabinat e avionëve, që qëndronin si zogj të ergjëndë në krah të njeri tjetrit.

Stërvitja "çifti roje në kapje" filloi. Nëntoger Niko Baftjari ishte i urdhëruar që me avionin Nr. 151 të udhëhiqte

çiftin gjatë kapjes së shenjës "armike". Me t'u-futur në kabinën e reaktivit ai vuri shlemofonin dhe veshi parashutën, lidhi dhe shtrëngoi rrypat dhe pasi solli çelsin e akumulatorit, hapi radion. Të gjitha këto veprime i bëri me shpejtësi të madhe e me përpikmëri. Ndërkaq, nëpërmjet kufjeve të shlemofonit filloi të dëgjonte një fëshfërimë të lehtë: po vihej në lidhje me vend-komandën.

"151, në çift" i raportoi komandantit epror.

"Kuptuam. Lëshojeni!"

### QUESTIONS

1. Kush ka kryer akademinë e aviacionit?
2. Cilën shkollë ka kryer Nëntoger Niko Baftjari?
3. Kush është tani pilot ndjekës?
4. Çfarë piloti është ai tani?
5. Ç'duhet të vazhdojë ai si i tillë edhe për një vit tjetër?
6. Edhe për sa kohë duhet t'i vazhdojë ai stërvitjet?
7. Kush duhet të ketë njohuri më të mira pilotazhi?
8. Ç'duhet të ketë një nëntoger që sapo ka kryer akademinë e aviacionit?
9. Cilat detyra duhet të zbatojë më mirë një nëntoger i aviacionit?
10. Kush duhet t'i zbatojë mirë detyrat luftarake?
11. Cilat detyra janë të koklavitura?
12. Qysh janë detyrat e fluturimit?
13. Çfarë stërvitje është kjo e sotmja?
14. Cila është një stërvitje me karakter mësimor?
15. Çfarë objekti u-zbulua në një nga këto stërvitje?
16. Ç'i ngjau një objekti ajror armik?
17. Në cilën dhomë u-dëgjua sinjali i alarmit luftarak?
18. Ç'u-dëgjua në dhomën e pilotëve?
19. Cilët qëndronin në gadishmërinë Nr. 2?
20. Në ç'gadishmëri qëndronin pilotët?
21. Zëri i kujt kumboi menjëherë pas këtij sinjali?



22. Kur kumboi zëri i telefonistit të repartit?
23. Kush u tha pilotëve të kalonin "në njëshin", d.m.th. në gadishmërinë Nr. 1?
24. Ç'urdhër u-dëgjua pas sinjalit luftarak?
25. Si u-përgjigj piloti Niko Baftjari?
26. Kush u-përgjigj "Kuptuam. Në njëshin"?
27. Ç'bëri piloti Niko Baftjari drejt reaktivit të tij?
28. Drejt cilit reaktiv vrapoi piloti Niko Baftjari?
29. Pas kujt vinte Selman Zagari, një pilot tjetër i ri?
30. Kush vinte pas tij?
31. Cilët pilotë hynë në kabinat e avionëve?
32. Ç'bënë të dy pilotët?
33. Cilët qëndronin si zogj të ergjëndë në krah të njeri tjetrit?
34. Ku qëndronin avionët si zogj të ergjëndë?
35. Cila stërvitje filloi?
36. Çka filloi?
37. Cili nëntoger ishte i urdhëruar të udhëhiqte çiftin?
38. Kush ishte i urdhëruar të udhëhiqte çiftin gjatë kapjes së shenjës armike?
39. Ç'ishte i urdhëruar të bënte Nëntoger Niko Baftjari?
40. Avioni i kujt kishte numrin 151?
41. Ç'numër kishte avioni i Nëntoger Niko Baftjarit?
42. Ç'bëri ai me t'u-futur në kabinën e reaktivit?
43. Kur e vuri ai lemofonin dhe veshi parashutën?

44. Ç'lidhi dhe ç'shtrëngoi ai?
45. Ç'u bëri rrypave?
46. Ç'bëri pasi solli çelsin e akumulatorit?
47. Kur e hapi radion?
48. Si i bëri ai të gjitha këto veprime?
49. Kush i bëri të gjitha këto veprime me shpejtësi të madhe e me përpikmëri?
50. Ç'filloi të dëgjonte ndërkaq?
51. Kur filloi të dëgjonte një fëshfërimë të lehtë?
52. Nëpërmjet cilave kufje dëgjoi një fëshfërimë të lehtë?
53. Çfarë fëshfërimë dëgjoi nëpërmjet kufjeve të shlemofonit?
54. Cili po vihej në lidhje me vend-komandën?
55. Me cilën komandë po vihej në lidhje?
56. Kush i raportoi komandantit epror "151, në çift"?
57. Kujt i raportoi piloti "151, në çift"?
58. Kush u-përgjigj "Kuptuam. Lëshojeni!"?
59. Ç'urdhër dha komandanti epror?
60. Nga cili vend e dha komandanti këtë urdhër?

## VOCABULARY

akumulator, -i (m.) akumulatorë, -t	storage battery
alarm, -i (m.) alarme, -t	alarm
çift, -i (m.) çifte, -t	twosome, couple
i, e, të ergjëndë të ergjënda (adj. m. & f.)	see "i argjendë"
fëshfërimë, -a (f.) fëshfërima, -t	rustle, rustling
gadishmëri, -a (f.)	readiness; alert
gadishmëria Nr. 1	(the pilots enter the cockpit)
gadishmëria Nr. 2	(the airplanes are on the runway)
karakter, -i (m.) karaktere, -t	character
i, e, të koklavitur të koklavitura (adj. m. & f.)	complicated; complex
kufje, -a (f.) kufje, -t	earphone
për të kumbuar (v.) (kumbon)	to echo; to resound
lidhje, -a (f.) lidhje, -t	connection, bond, tie; league
luftarak, -e (adj. m. & f.)	combat, fighting, warlike
mësimor, -e (adj. m. & f.)	educational, instructive

ndjekës, -e (adj. m. & f.)	intercepting; pursuing
nëpërmjet (prep.)	through, by means of
njësh, -i (m.) njëshc, -t	(the) number one
objekt, -i (m.) objekte, -t	object
përpikmëri, -a (f.)	see "përpikni"
sapo (conj.)	just; as soon as
telefonist, -i (m.) telefonistë, -t	telephone operator
i, e, të urdhëruar të urdhëruara (adj. m. & f.)	ordered
vend-komandë, -a (f.) vend-komanda, -t	control tower

## IDIOMS

Me t'u-futur në kabinën e....	As soon as he entered the cockpit....
Kuptuam.	Roger. (radio & signaling)
Lëshojeni!	Take off! Let it go!
Për t'u-vënë në lidhje (me) (unë vihem në lidhje (me))	to contact, communicate

Mësimi i 112-të

## ÇIFTI ROJE NË KAPJE

### Pjesa e dytë

Sinjali për fluturim u-dha dhe akrepi i kronometrit nuk kish bërë ende rrethin e plotë kur aeroplani i Nëntoger Niko Baftjarit u-ngrit dhe fluturoi në ajr. Pas tij vinte avioni shoqërues që pilotohej nga Selman Zagari. Me shpejtësi të madhe ata arritën në largësinë e caktuar dhe pilotët shikonin me vemendje në hapësirën e qiellit. Diku aty rrotull gjendej objektivi ajror; ai duhej kërkuar dhe zbuluar.

Nga vend-komanda herë pas here jepeshin urdhëra të prerë:

"151, kursi 160, shpejtësia 700, lartësia 8000."

Piloti vepronte sipas të dhënave që kish marrë. Reaktivi herë ngjitej lart e herë ulej poshtë, si një shigjetë e zjarrtë.

"Shiko përpara 15 km.!" u-dëgjua përsëri në kufjet e pilotit zëri që vinte nga vend-komanda.

Duke pilotuar maqinën me mjeshtëri, piloti shikoi nga drejtimi i dhënë. Ca çaste më vonë ai diktoi një njollë të zezë, e cila sa vinte zmadhohej. Objektivi ishte zbuluar para kohe.

"151, shikoj objektivin. Më lejoni atakimin?"

"Ju lejojmë."

Kjo ishte komanda e fundit për atë ditë. Me të marrë urdhërin, reaktivi zuri vendin e përshtatshëm për sulm dhe pastaj u-lëshua poshtë si rrufe. Objektivi u-regjistrua në shinjestër dhe piloti shtypi sustën.

Deshifrimi i fotografive tregoi se gjuajtësi e kish goditur me saktësi objektivin ajror.

## PYETJE

1. Cili sinjal u dha?
2. Ç'u-dha për fluturim?
3. Aeroplani i kujt u-ngrit dhe fluturoi në ajr?
4. Ç'bëri aeroplani i Nëntoger Niko Baftjarit?
5. Cili akrep nuk e kish bërë ende rrethin e plotë kur aeroplani u-ngrit dhe fluturoi në ajr?
6. Ç'ngjau kur akrepi i kronometrit nuk e kish bërë ende rrethin e plotë?
7. Cili avion vinte pas tij?
8. Pas kujt vinte avioni shoqërues?
9. Cili avion pilotohej nga Selman Zagari?
10. Nga kush pilotohej avioni shoqërues?
11. Cilët arritën me shpejtësi të madhe në largësinë e caktuar?
12. Me çfarë shpejtësie arritën ata në largësinë e caktuar?
13. Ç'bënin pilotët me vemendje në hapësirën e qiellit?
14. Qysh shikonin pilotët në hapësirën e qiellit?
15. Cili objektiv gjendej diku aty rrotull?
16. Ku gjendej objektivi ajror?
17. Cili objektiv duhej kërkuar dhe zbuluar?
18. Ç'duhej bërë kur pilotët arritën në largësinë e caktuar?
19. Nga ku jepshin urdhëra të prerë herë pas here?
20. Çfarë urdhërash jepeshin nga vend-komanda herë pas here?
21. A janë "151, kursi 160, shpejtësia 700, lartësia 8000" disa nga këto urdhëra?

22. Cilët janë urdhërat e prerë që jepeshin herë pas here?
23. Kush vepronte sipas të dhënave që kish marrë?
24. Si vepronte piloti?
25. Cili herë ngjitej lart e herë ulej poshtë?
26. Ç'bënte reaktivi si një shigjetë e zjarhtë?
27. Ku u-dëgjua përsëri zëri që vinte nga vend-komanda?
28. Ç'u-dëgjua përsëri në kufjet e pilotit?
29. Kush dëgjoi urdhërin "shiko përpara 15 km."?
30. Çfarë urdhëri dëgjoi piloti në kufjet e tija?
31. Kush shikoi nga drejtimi i dhënë duke pilotuar maqinën me mjeshtëri?
32. Nga shikoi piloti duke pilotuar maqinën me mjeshtëri?
33. Kur diktoi ai një njollë të zezë, e cila sa vinte zmadhohej?
34. Ç'diktoi piloti ca çast me vonë?
35. Ç'ishte zbuluar para kohe?
36. Kur ishte zbuluar objektivi?
37. Kush tha "151, shikoj objektivin. Më lejoni atakimin?"
38. Ç'bëri piloti?
39. Kush u-përgjigj "Ju lejojmë"?
40. Si u-përgjigj vend-komanda?
41. A ishte kjo komanda e fundit që u-dha për atë ditë?
42. Cila ishte komanda e fundit që u-dha?
43. Kush zuri vendin e përshtatshëm për sulm, me të marrë urdhërin?
44. Ç'bëri reaktivi, me të marrë urdhërin?



45. Pastaj qysh u-lëshua poshtë?
46. Ç'bëri pastaj reaktivi?
47. Ç'u-regjistrua në shinjestër?
48. Ku u-regjistrua objektivi?
49. Kush shtypi sustën?
50. Ç'bëri piloti?
51. Cili deshifrim tregoi se gjuajtësi e kish goditur me saktësi objektivin ajror?
52. Cilin objektiv tregoi deshifrimi i fotografive se gjuajtësi e kish goditur me saktësi?

## FJALOR

akrep, -i (m.) akrepë, -t	hand on a dial (watch, clock, etc.); scorpion
atakim, -i (m.) atakime, -t	attack
deshifrim, -i (m.) deshifrimi, -t	decoding
për të diktuar (v.) (unë diktoj)	to detect, discover; to dictate
të dhëna, -t (f. pl.)	data
i, e, të dhënë të dhëna (adj. m. & f.)	see "i dhënan"
për të goditur (v.) (unë godit)	to hit, strike; to build; to fix
gjuajtës, -i (m.) gjuajtës, -it	interceptor
herë (adv.)	see "nganjihcrë"
për t'u-kërkuar (v.) (unë kërkohem)	to be sought, searched, looked (for); to be required; to be wanted (law)
kronometër, kronometri kronometra, -t (m.)	chronometer
largësi, -a (f.) largësi, -të	distance
lartësi, -a (f.) lartësi, -të	height, altitude, elevation
për t'u-pilotuar (v.) (pilotohet)	to be piloted

i, e, të prerë  
të prera  
(adj. m. & f.)

see "i prem"

sustë, -a (f.)  
susta, -t

button; spring, coil

shigjetë, -a (f.)  
shigjeta, -t

arrow

për të shtypur (v.)  
(unë shtyp)

to push, press; to crush, tread;  
to run over; to print

i, e, të zjarrtë  
të zjarra  
(adj. m. & f.)

fiery; ardent, passionate

#### SHËNIME

diku aty rrotull

somewhere around

me mjeshtëri

skillfully

para kohe

in advance; prematurely

Mësimi i 113-të

PËR TË SHPËTUAR JETËN E NJË TË SËMURI

Pjesa e parë

Nuk ishte kohë për fluturim. Re të dendura e të zeza e kishin mbuluar Tiranën; Dajti s'dukej fare. Aeroporti atë mesditë ishte i qetë. Kapiteni po përgatitej për të shkuar në shtëpi kur një ushtar u-duk në derë dhe i tha se e kërkonte komandanti. U-ngrit dhe dolli jashtë.

"Zoti Kolonel! Kapiten Spiro Polena, sipas urdhërit tuaj, ju paraqitet."

Komandanti e njoftoi se në Kukës ishte në rrezik jeta e një të sëmuri dhe se atje duhej çuar menjëherë një mjek specialist.

"Merr të dhënat meteorologjike, si pilot të lytë Gaqo Bahollin dhe nisu!" urdhëroi komandanti.

Buletini meteorologjik shënonte se gjer në Kukës ishte e pamundur të fluturohej.

"E paskemi pisk sot, Zoti Kolonel. Njeriu i sëmurë duhet shpëtuar, por mund të ndodhë një gjë akoma më e tmershme: të vdesin dy pilotë, një teknik dhe mjeku" tha Kapiten Polena.

"E di" tha komandanti duke vërtitur në duar buletinin; u-mendua për një çast dhe. i vendosur, shtoi: "Sidoqoftë, nisu!"

Brdhi edhe doktori me çantën e tij të rëndë; dukej i lodhur.

"Ku do të hypim?" pyeti ai.

"Ja, tek ai me dy fletë" i u-përgjigj kapiteni duke i a bërë me kokë. Ku t'a dinte i shkreti doktor se ç'rrugë e priste!

Aeroplani dolli në pistë dhe duke lënë pas një gjëzim të fortë u-çkëput nga toka. Kapiteni pa figurën e komandantit që sa vinte po bëhej më e vogël. Doktori ishte mbledhur shuk, i menduar. Zhgaba e hekurt fluturonte drejt Shkodrës.

Mbi Milot piloti mori kthesën e parë për në Pukë, sipas llogaritjeve shturmane. Përpara retë ishin si jorganë viganë, re të rënda, të zeza e të hatashme. Shtatë minuta brenda në këto re; piloti nuk shihte dot as fletët e aeroplanit. Fluturime të tilla për pilotët janë plot tension, plot nerva. Puka vazhdonte të ishte përpara. Malet kishin një lartësi mbi 1700 metra, mirëpo piloti, nga që u-nis shpejt, lartësinë e mori 1300 metra. Me këtë lartësi nuk kalohej.

## PYETJE

1. Për se nuk ishte koha?
2. Çfarë kohe nuk ishte?
3. Cilin qytet e kishin mbuluar re të dendura e të zeza?
4. Çfarë resh e kishin mbuluar Tiranën?
5. Cili mal s'dukej fare?
6. Qysh ishte aeroporti atë mesditë?
7. Kur ishte i qetë aeroporti?
8. Kush po përgatitej për të shkuar në shtëpi?
9. Ç'po bënte kapiteni atë mesditë?
10. Kush u-duk në derë?
11. Ku u-duk një ushtar?
12. Kujt i tha se e kërkonte komandanti?
13. Kush e kërkonte kapitenin?
14. Kush u-ngrit e dolli jashtë?
15. Ç'bëri kapiteni?
16. Kujt i u-paraqit?
17. Kush e njoftoi se në Kukës ishte në rrezik jeta e një të sëmuri?
18. Cilin njoftoi komandanti se në Kukës ishte në rrezik jeta e një të sëmuri?
19. Ku duhej çuar menjëherë një mjek specialist?
20. Çfarë mjeku duhej çuar atje menjëherë?
21. Ç'duhej bërë menjëherë?

22. Kush i tha kapitenit të merrte të dhënat meteorologjike?
23. Çfarë të dhënash duhet të merrte Kapiten Polena?
24. Cilin pilot do të merrte si pilot të dytë?
25. Me ç'detyrë do t'a merrte kapiteni Gaqo Bahollin kur të nisej?
26. Kush e dha këtë urdhër?
27. Ç'bëri komandanti?
28. Cili buletin shënonte se gjer në Kukës ishte e pamundur të fluturohej?
29. Ç'shënonte buletini meteorologjik?
30. Kush tha: "E paskemi pisk sot, Zoti Kolonel"?
31. Ç'tha Kapiten Polena?
32. A duhej shpëtuar njeriu i sëmurë sipas kapitenit?
33. Cili duhej shpëtuar?
34. Por, çfarë mund të ndodhte akoma më e tmershme?
35. Çfarë gjëje mund të ndodhte?
36. Sa pilotë, sa teknikë e sa mjekë mund të vdisnin?
37. Cilët mund të vdisnin në këtë fluturim?
38. Ç'mund t'u ndodhte dy pilotëve, një tekniku dhe mjekut?
39. Kush tha kështu?
40. Ç'tha Kapiten Polena?
41. Kush tha: "E di" duke vërtitur në duar buletinin?
42. Ç'tha komandanti duke vërtitur në duar buletinin?
43. Kush u-mendua për një çast dhe, i vendosur, shtoi: "Sidoqoftë, nisu!"?

44. Ç'bëri komandanti pasi u-mendua për një çast?
45. Kush erdhi me çantën e tij të rëndë?
46. Ç'bëri doktori?
47. Kush dukej i lodhur?
48. Qysh dukej doktori?
49. Cili pyeti: "Ku do të hypim?"
50. Ç'pyeti doktori?
51. Kush u-përgjigj: "Ja, tek ai me dy fletë" duke i a bërë me kokë?
52. Ç'u-përgjigj kapiteni duke i a bërë me kokë?
53. Ku dolli aeroplani?
54. Prej nga u-çkëput duke lënë pas një gjënim të fortë?
55. Qysh u-çkëput nga toka?
56. Kush pa figurën e komandantit që sa vinte po bëhej më e vogël?
57. Figurën e kujt pa kapiteni që sa vinte po bëhej më e vogël?
58. Cili ishte mbledhur shuk, i menduar?
59. Ç'fluturonte drejt Shkodrës?
60. Për ku fluturonte zhgaba e hekurt?
61. Mbi cilën pikë mori piloti kthesën e parë për në Pukë?
62. Ç'bëri piloti mbi Milot sipas llogaritjeve shturmane?
63. Sipas cilave llogaritje mori piloti mbi Milot kthesën e parë për në Pukë?
64. Ku ishin retë si jorganë viganë?
65. Qysh ishin retë përpara?



L. 113

66. Cilat ishish të rënda, të zeza e të hatashme?
67. Qysh ishish retë përpara?
68. Sa minuta kaluan brenda në këto re?
69. Ku kaluan shtatë minuta?
70. Kush nuk shihte dot as fletët e aeroplanit?
71. Cilat fletë nuk shihte dot piloti?
72. Cilat fluturime për pilotët janë plot tension, plot nerva?
73. Qysh janë për pilotët fluturime të tilla?
74. Cili vend vazhdonte të ishte përpara?
75. Ku vazhdonte të ishte Puka?
76. Ç' lartësi kishin malet?
77. Kush e mori lartësinë 1300 metra, nga që u-nis shpejt?
78. Mirëpo, ç'bëri piloti, nga që u-nis shpejt?
79. A kalohej me 1300 m. lartësi?
80. Me ç' lartësi nuk kalohej?

## FJALOR

buletin, -i (m.) buletine, -t	bulletin
për t'u-çkëputur (v.) (unë çkëputem)	to be detached; to break off; to get away
figurë, -a (f.) figura, -t	figure; image
për t'u-fluturuar (v.) (fluturohet)	to be flown
gjënim, -i (m.) gjëmime, -t	roar; echo; thunder
i, të hatashëm e, të hatashme (adj. m. & f.)	terrible, terrifying, dreadful
ja (interj.)	here it is, there it is, here you are
jorgan, -i (m.) jorganë, -t	quilt
për t'u-kaluar (v.) (kalohet)	to be passed; to be crossed; to be spent
llogaritje, -a (f.) llogaritje, -t	calculation
i, e, të menduar të menduara (adj. m. & f.)	thoughtful (lost in thought), pensive
meteorologjik, -e (adj. m. & f.)	meteorologic, meteorological
nerv, -i (m.) nerva, -t	nerve
pistë, -a (f.) pista, -t	runway, landing strip

L. 113

i sëmurë, -i (m.) të sëmurë, -t	the sick; patient
për t'u-shpëtuar (v.) (unë shpëtohem)	to be rescued, saved
shturman, -e (adj. m. & f.)	navigational
tek (prep.)	see "te or ke"
teknik, -u (m.) teknikë, -t	technician
tension, -i (m.) tensione, -t	tension
i, e, të vendosur të vendosura (adj. m. & f.)	determined, decided
për të vërtitur (v.) (unë vërtit)	to turn, revolve
vigan, -e (adj. m. & f.)	giant, gigantic
zhgabë, -a (f.) zhgaba, -t	eagle

#### SHËNIME

duke i a bërë me kokë	pointing at it with his head
ku t'a dinte i shkreti doktor	and how did the poor doctor know
i mbledhur shuk	huddled up, doubled up
nga që....	since; because
E paskemi pi:	We are in trouble; I feel the pinch
plot nerva	nerve-racking
nuk shihte dot	he couldn't see

Mësimi i 114-të

PËR TË SHPËTUAR JETËN E NJË TË SËMURI

Pjesa e dytë

"Lidhuni!" urdhëroi kapiteni dhe filloi t'a ngrejë aeroplanin, por lëkundjet ishin të forta.

"Ç'bëhet kështu?" pyeti mjeku.

"Mos u-trondi, doktor. Do të arrijmë në Kukës të pacenuar" tha piloti.

Sa më shumë që ngjitej aeroplani aq më shumë dridhej.

"Këtej s'kafohet. Të kthehemi prapë mbi Milot" urdhëroi kapiteni.

"Ç'bëhet kështu?" pyeti prapë mjeku.

"Doktor, mos u-mërzit! Do t'i biem nga Vau i Dejës."

Këtej qielli kish copa të kaltra, por nga veriu vinte një "front resh" siç shprehen pilotët, dhe nga larg dukeshin shkrepëtima.

"Andej nga ai tufan do të kalojmë" tha piloti.

Kur arritën mbi Vaun e Dejës kapiteni urdhëroi pilotin e dytë:

"Kursin për në Pukë!" dhe përsëri u-futën në re. Papritmas u-duk një dritare ajrore dhe piloti vështroi poshtë.

"Puka!" tha ai, por Puka u-fsheh përsëri. As Gjalica nuk dukej, as qafa e malit.

"Kursin për në Luginën e Drinit" urdhëroi piloti; atje mund të fluturoje me një lartësi më të ulët.

"Mund të përplasemi në ndonjë shpat" tha tekniku i shqetësuar.

Aeroplani doli papritmas në qiell të pastër dhe edhe për pak ndodhi katastrofa: desh u-përplasën në pishat e Pukës.

Aeroplani bëri një rreth 360° mbi Pukë që të fitonte kohë sa të kalonte fronti i reve të dendura. Dhe fronti i reve kaloi duke liruar rrugën për në Kukës. Pesëmbëdhjetë minuta tjerë kaluan gjersa arritën mbi aeroportin e Kukësit, ku u-duk një maqinë me dy njerëz me të bardha.

"Më presin mua" tha mjeku duke qeshur. Të tërë merrnin frymë lirisht.

## PYETJE

1. Kush urdhëroi "Lidhuni!"?
2. Ç'urdhëroi kapiteni?
3. Cili filloi t'a ngrejë aeroplanin?
4. Ç'filloi kapiteni të bëjë?
5. Qysh ishin lëkundjet?
6. Cilat ishin të forta?
7. Kush pyeti: "Ç'bëhet kështu?"
8. Ç'pyeti mjeku?
9. Cili tha: "Mos u-trondit doktor! Do të arrijmë në Kukës të pacenuar"?
10. Ç'tha piloti?
11. Kush tha: "Do t'i biem nga Vau i Dejës"?
12. Çfarë tha piloti?
13. A kish qielli copa të kaltra nga Vau i Dejës?
14. Ç'kish qielli nga Vau i Dejës?
15. Nga vinte një front resh?
- 16.. Ç'vinte nga veriu?
17. Nga dukeshin shkrepëtima?
18. Ç'dukeshin nga larg?
19. Kush tha: "Andej nga ai tufan do të kalojmë!"?
20. Çfarë tha piloti?
21. Kush e urdhëroi pilotin e dytë: "Kursin për në Pukë!" kur arritën mbi Vaun e Dejës?

22. Ç'urdhëroi kapiteni kur arritën mbi Vaun e Dejës?
23. Ku u-futën përsëri?
24. Ç'bënë përsëri në re?
25. Ç'u-duk papritmas?
26. Kur u-duk një dritare ajrore, a vështroi për atë piloti?
27. Ç'bëri piloti kur u-duk një dritare ajrore?
28. Kush tha "Puka!", por Puka u-fsheh përsëri?
29. Ç'tha piloti?
30. Cili urdhëroi: "Kursin për në luginën e Drinit!"?
31. Ç'urdhër dha piloti?
32. Ku mund të fluturoje me një lartësi më të ulët?
33. Ç'mund të bëje atje, në Luginën e Drinit?
34. Kush tha i shqetësuar: "Mund të përplasemi në ndonjë shpat"?
35. Ç'tha tekniku i shqetësuar?
36. Ç'dolli papritmas në qiell të pastër?
37. Ku dolli aeroplani papritmas?
38. A qe gati duke ndodhur një katastrofë kur aeroplani dolli në qiell të pastër?
39. A u-përplas aeroplani në pishat e Pukës?
40. Ku desh u-përplas aeroplani?
41. Ç'rreth bëri aeroplani mbi Pukë që të fitonte kohë?
42. Ku bëri aeroplani një rreth 360° që të fitonte kohë?
43. Pse bëri aeroplani mbi Pukë një rreth 360°?
44. Ç'bëri aeroplani mbi Pukë sa të kalonte fronti i rëve të dendura?

45. Cili bëri një rreth  $360^\circ$  mbi Pukë që të fitonte kohë sa të kalonte fronti i reve të dendura?
46. Duke kaluar re, a u-lirua rruga për në Kukës?
47. Ç'kaloi, duke liruar rrugën për në Kukës?
48. Sa minuta tjerë kaluan gjersa arritën mbi aeroportin e Kukësit?
49. Ku arritën pasi kaluan pesëmbëdhjetë minuta tjerë?
50. Ku u-duk një makinë me dy njerëz me të bardha?
51. Ç'u-duk në aeroport me dy njerëz me të bardha?
52. Kush tha duke qeshur: "Më presin mua"?
53. Ç'tha mjeku duke qeshur?
54. Cilët merrnin frymë lirisht?
55. Ç'bënin të tërë në aeroplan?



## FJALOR

desh (adv.)	almost
katastrofë, -a (f.) katastrofa, -t	catastrophe
lëkundje, -a (f.) lëkundje, -t	shake, shock, tremor; sway, swing
për t'u-lidhur (v.) (unë lidhem)	to fasten, tie oneself; to be tied; to be handcuffed
për të liruar (v.) (unë liroj)	to free; to release; to loosen; to vacate; to relieve; to reduce (the price of....)
i, e, të pacenuar të pacenuara (adj. m. & f.)	untouched, intact; unharmed
për t'u-përplasur (v.) (unë përplasem)	to crash; to slam; to hit; to collide, to bump into
pishë, -a (f.) pisha, -t	pine tree
qafë, -a (f.) qafa, -t	neck; mountain pass
shkrepëtimë, -a (f.) shkrepëtima, -t	lightning
për t'u-shprehur (v.) (unë shprehem)	to express oneself
i, e, të shqetësuar të shqetësuar (adj. m. & f.)	concerned; worried; upset; disturbed
për t'u-tronditur (v.) (unë tronditem)	to be shaken; to be shocked
tufan, -i (m.)	storm

SHËNIME

Ç'bëhet kështu?

What's going on?

do t'i biem nga....

we'll go through  
we'll pass through  
we'll go the way of....

...merrnin frymë lirisht

...they were relieved

dy njerëz me të bardha

two men dressed in white

Mësimi i 115-të

### USHTRIME FLUTURIMI ME NJË NXËNËS PILOT

Qazim Deliallisi studjon për pilot. Instruktori i tij i pilotazhit është një ish-major i aviacionit; gjatë Luftës së Dytë Botërore pilotonte avionë të rëndë bombardues, që fluturojnë distanca të gjata. Ca ditë para se të mbaronte lufta, ndërsa po fluturonte mbi tokën e armikut, zjarri i përqëndruar mirë i topave kundërajrorë e goditi keq. Një predhë i ra fletëzës vertikale dhe një tjetër i shtrembëroi helikën. Ai dhe i tërë ekipazhi u-hodhën me parashutë në prapavijat e armikut. Si mbaroi lufta, ai u-emërua instruktor në Shkollën e Pilotazhit për Aviatorë Civilë. Atë e mbajnë si një nga instruktorët më të mirë, megjithëse është pak i egër; nxënësit e tij, pasi mbarojnë kursin e pilotazhit, e zotërojnë mirë mjeshtërinë e pilotit.

Qazimi dhe instruktori hypin në avion dhe pasi lidhen, Qazimi hap radion dhe vihet në lidhje me vend-komandën; kjo i thotë të drejtohet nga pista dhe të ndalet në krye të saj. Ndërsa është duke pritur urdhëra nga vend-komanda, instruktori i thotë Qazimit:

"Deliallisi! Cilat janë manovrimet që duhet të kryesh gjatë këtij fluturimi?"

"Të ngrihem, të bëj dy pjerrje duke mbajtur të njëjtën lartësi, të bëj një kthesë dhe të zbres" përgjigjet piloti.

"Të tamam. Tani konsideroje veten sikur je vetëm në avion. Mos prit urdhëra nga unë; unë jam këtu vetëm që të qortoj gabimet" i thotë instruktori.

"Këtu është vend-komanda. Thërres avionin A91. Këtu është vend-komanda. Thërres avionin A91."

"Këtu është avioni A91. Urdhëroni!"

"Pista është e lirë. Lëshojeni!"

"Kuptuam." Në këtë çast piloti i ri fillon t'i japë gaz dhe nëpërmjet timonit fillon të ulë fletëzat dhe fletëzat e bishtit që të ngrihet.

"Jepi gaz më shumë!" e këshillon instruktori.

"Lartësia 1650 metra" njofton piloti.

Pasi bën pjerrjen e parë, instruktori ndërhyt sepse nxënësi nuk e mbajti avionin në të njëjtën lartësi.

"E pashë edhe vetë që pjerrjen e bëra duke zbritur. T'a provoj edhe një herë?"

"Po, provoje nga e majta këtë radhë!

.....

"Mirë. Tani bën një kthesë dhe bëhu gati që të zbrisim.  
Kursi 120." Këto janë fjalët e fundit që thotë instruktori.

PYETJE

1. Kush studjon për pilot?
2. Për çka studjon Qazim Deliallisi?
3. Ç'ka qenë më parë instruktori i tij i pilotazhit?
4. Ç'illoj avionësh pilotonte instruktori i Qazimit gjatë Luftës së Dytë Botërore?
5. Kush pilotonte gjatë Luftës së Dytë Botërore avionë të rëndë bombardues që fluturojnë distanca të gjata?
6. Ç'i ngjau instrukturit të Qazimit ca ditë para se të mbaronte lufta ndërsa po fluturonte mbi tokën e armikut?
7. Ç'e goditi avionin e tij mbi tokën e armikut?
8. Qysh e goditi aeroplanin e tij zjarri i përqëndruar mirë i topave kundërajrorë të armikut?
9. Ç'pjese të avionit i ra një predhë e armikut?
10. Cilës fletëz të avionit i ra një predhë e armikut?
11. Ç'i ngjau helikës së aeroplanit nga një predhë e armikut?
12. Pse u-shtrembërua helika e avionit?
13. Ç'bënë pastaj ish-majori dhe ekipazhi i avionit?
14. Ku u-hodhën me parashutë ish-majori dhe ekipazhi i avionit?
15. Në cilat prapavija u-hodhën me parashutë ekipazhi dhe ish-majori?
16. Me ç'punë u-emërua ish-majori pasi mbaroi lufta?
17. Në cilën shkollë u-emërua instruktor ish-majori?
18. Qysh e konsiderojnë nxënësit instruktorin e tyre?
19. Qysh e zotërojnë mjeshtërinë e pilotit nxënësit pasi mbarojnë kursin me këtë instruktor?

20. Ku hypin Qazimi dhe instruktori i tij?
21. Ç'bëjnë ata para se hap radion Qazimi?
22. Me kë vihet në lidhje Qazimi me anë të radios?
23. Nga i thotë vend-komanda Qazimit të drejtohet?
24. Çka tjetër i thotë të bëjë pasi t'a drejtojë avionin nga pista?
25. Ndërsa është duke pritur urdhëra nga vend-komanda, a i bën instruktori Qazimit këtë pyetje: "Deliallisi! Cilat janë manovrimet që duhet të kryesh gjatë këtij fluturimi?"
26. Ç'pyetje i bën instruktori Qazimit?
27. A i jep Qazimi instruktorit këtë përgjegje: "Të ngrihem, të bëj dy pjerrje duke mbajtur të njëjtën lartësi, të bëj një kthesë dhe të zbres?"
28. Ç'përgjegje i jep Qazimi instruktorit?
29. Ç'duhet të bëjë Qazimi në fillim fare?
30. Sa pjerrje duhet të bëjë dhe çfarë lartësie duhet të mbajë?
31. Ç'duhet të bëjë pasi të bëjë një kthesë?
32. Kur duhet të zbresë?
33. A i thotë instruktori: "Tamam. Tani konsideroje veten sikur je vetëm në avion. Mos prit urdhëra nga unë; unë jam këtu që të qortoq gabimet?"
34. Ç'i thotë instruktori Qazimit?
35. Si duhet t'a konsiderojë veten në avion Qazimi?
36. Ç'nuk duhet të presë Qazimi nga instruktori i tij?
37. Pse është ahëre instruktori në avion?
38. A thërret vend-komanda: "Këtu është vend-komanda. Thërres avionin A91"?

39. Qysh e thërret vend-komanda avionin A91?
40. Kush e thërret me radio avionin e Qazimit?
41. Ç'numër ka avioni që është duke pilotuar Qazimi?
42. A i përgjigjet Qazimi vend-komandës: "Këtu është avioni A91. Urdhëroni!"?
43. Ç'i përgjigjet Qazimi thirrjes së vend-komandës?
44. A i thotë vend-komanda: "Pista është e lirë. Lëshojeni!"?
45. Ç'i komunikon vend-komanda Qazimit?
46. A i përgjigjet Qazimi vend-komandës: "Kuptuam"?
47. Ç'i përgjigjet Qazimi vend-komandës pasi kjo dha udhëzimet e nevojshme?
48. Ç'bën në këtë çast piloti i ri?
49. Ç'vegël përdor që të ulë fletëzat dhe fletëzat e bishtit për t'u-ngritur?
50. Ç'bën me anë të timonit?
51. A e këshillon instruktori duket i thënë: "Jepi gaz më shumë!"?
52. Ç'e këshillon instruktori Qazimin të bëjë?
53. Në ç'lartësi njofton piloti se është aeroplani?
54. Pse ndërhyri instruktori pasi nxënësi bëri pjerrjen e parë?
55. Në ç'lartësi nuk e mbajti piloti avionin?
56. A i u-përgjigj nxënësi instruktorit: "E pashë edhe vetë që pjerrjen e bëra duke zbritur"?
57. Si u-përgjigj nxënësi instruktorit?
58. Në ç'fazë të fluturimit e bëri piloti pjerrjen?
59. A e pyeti edhe: "T'a provoj edhe një herë?"



60. Ç'e pyeti nxënësi instrukturin e tij?
61. Ç'kërkoi të bënte edhe një herë piloti?
62. A i tha instruktori: "Po, provoje nga e majta këtë radhë!"?
63. Ç'i tha instruktori pilotit?
64. Nga cila anë i tha t'a provojë t'a bëjë pjerrjen këtë radhë?
65. Ç'bëri piloti sipas udhëzimeve të instruktorit?
66. Pastaj, a i tha: "Mirë. Tani bën një kthesë dhe bëhu gati që të zbresim. Kursi 120."?
67. Ç'i tha instruktori pilotit pasi ky veproi sipas këshillave të tia?
68. Ç'i tha instruktori pilotit të bënte para se të zbriste?
69. Sa do të ishte kursi?

## FJALOR

distancë, -a (f.)  
distanca, -t

distance

për t'u-emëruar (v.)  
(unë emërohem)

to be nominated, named

fletëz, -a (f.)  
fletëza, -t

aileron (control flap)

fletëza e bishtit

elevator (aircraft)

fletëza vertikale

rudder (aircraft)

helikë, -a (f.)  
helika, -t

propeller

instruktor, -i (m.)  
instruktorë, -t

instructor

për të konsideruar (v.)  
(unë konsideroj)

to consider

megjithëse (conj.)

see "megjithëqë"

pjerrje, -a (f.)  
pjerrje, -t

tilt, bank

për të qortuar (v.)  
(unë qorto)

to correct; to scold

si (conj.)

see "mbasi or pasi"

për të shtrembëruar (v.)  
(unë shtrembëroj)

to twist, distort

timon, -i (m.)  
timone, -t

control stick; rudder; steering wheel;  
helm; handle bar

për të zotëruar (v.)  
(unë zotëroj)

to master, command; to own

## SHËNIME

për t'i dhënë gaz  
(unë i jap gaz)

to give gas, to accelerate

## Mësimi i 116-të

### MBROJTJA KUNDËRAJRORE MODERNE

Mbrojtja Kundërajrore, si e thotë fjala vetë, ka të bëjë me mbrojtjen e një vendi nga sulmet ajrore. Puna e parë e njësive të MK-së është të vëzhguarit e avionëve armiq dhe të objekteve tjerë ajrorë. Në njësitë moderne të MK-së këtë punë e bëjnë radarët, që ndodhen të shpërndarë në katër anët e vendit. Radiolokatorët së bashku me njësitë tjera që quhen Pararojat e Vëzhguesve Ajrorë janë të parët që e zbulojnë armikun në hapësirë. Oficerët dhe teknikët e Pararojave të Vëzhguesve Ajrorë janë ekspertë në identifikimin e avionëve të ndryshëm dhe të objekteve ajrorë në përgjithësi.

Pasi objektivi ajror armik të jetë zbuluar, duhet ndjekur dhe shkatërruar. Kjo është punë e aviacionit ndjekës, pilotët e të cilit janë natë e ditë në gadishmëri.

Ka tri lloje gadishmëri:

Gadishmëria nr. 3. Gjatë kësaj kohe aeroplanat gjenden ndër hangarë, aviatorët në aeroport dhe merren me punë të ndryshme ose flejnë, por kudo qofshin ata duhet të jenë në gjendje të kalojnë në gadishmërinë nr. 2 brenda një ore.

Gadishmëria nr. 2. Gjatë kësaj kohe pilotët janë në dhomën e tyre, të veshur me kominoshen e pilotazhit; aeroplanat nxiren nga hangarët dhe vihen në pistë, gati për fluturim. Kjo periudhë zgjat zakonisht 15 minuta.

Gadishmëria nr. 1. Pilotët janë në avionë dhe presin sinjalin për fluturim.

Për shkatërrimin e objekteve ajrorë, përveç avionëve ndjekës, që në ditët tona janë të armatosur edhe me raketa, përdoren gjithashtu misilet e telekomanduar. Ka dy lloje misilesh të telekomanduar: misile që hudhen nga toka dhe misile që hudhen nga avioni.

## PYETJE

1. Si thotë fjala vetë, me çka ka të bëjë Mbrojtja Kundërajrore?
2. Cila fjalë tregon se me çka ka të bëjë Mbrojtja Kundërajrore?
3. Me mbrojtjen e çfarë vendi ka të bëjë Mbrojtja Kundërajrore?
4. Nga çfarë sulmesh mbrohet një vend nga Mbrojtja Kundërajrore?
5. Me çka mund të mbrohet një vend nga sulmet ajrore?
6. Të vëzhguarit e avionëve armiq është puna e parë e cilës mbrojtje?
7. Çfarë avionësh vëzhgojnë njësitë e Mbrojtjes Kundërajrore?
8. Cila është puna e parë e këtyre njësive?
9. Të vëzhguarit e cilëve objektive është puna e parë e Mbrojtjes Kundërajrore?
10. Çfarë pune bëjnë radiolokatorët në njësitë moderne të Mbrojtjes Kundërajrore?
11. Ku ndodhen të shpërndarë radiolokatorët?
12. Çfarë mjetesh ndodhen të shpërndarë në të katër anët e vendit?
13. Çka ndodhet në të katër anët e vendit?
14. Çka zbulojnë radarët në hapësirë?
15. Çka zbulojnë Pararojat e Vëzhguesve Ajrorë në hapësirë?
16. Çka zbulojnë radarët dhe Pararojat e Vëzhguesve Ajrorë në hapësirë?
17. Nga çka zbulohet armiku në hapësirë?

18. Në çë vend zbulohet armiku nga radarët dhe nga Pararojat e Vëzhguesve Ajrorë?
19. Cilët janë të parët që e zbulojnë armikun në hapësirë?
20. Në çfarë identifikimi janë ekspertë oficerët dhe teknikët e Pararojave të Vëzhguesve Ajrorë?
21. Cilët janë ekspertë në identifikimin e avionëve të ndryshëm?
22. Cilët janë ekspertë në identifikimin e objekteve ajrorë në përgjithësi?
23. Kush është ekspert në identifikimin e avionëve të ndryshëm dhe të objekteve ajrorë në përgjithësi?
24. Objektivi ajror i kujt duhet të zbulohet?
25. Çë duhet bërë pasi të jetë zbuluar objektivi ajror armik?
26. Çfarë objektivi duhet zbuluar, ndjekur dhe shkatërruar nga aviacioni ndjekës?
27. Çë bën aviacioni ndjekës?
28. Puna e cilit aviacion është t'a zbulojë, t'a ndjekë dhe t'a shkatërrojë objektivin ajror armik?
29. Pilotët e cilit aviacion janë natë e ditë në gadishmëri?
30. Kur janë, në gadishmëri pilotët e aviacionit ndjekës?
31. Cilët pilotë janë në gadishmëri natë e ditë?
32. Sa lloje gadishmëri ka?
33. Në cilën gadishmëri gjenden aeroplanat ndër hangarë?
34. Ku gjenden aeroplanat gjatë gadishmërisë Nr. 3?
35. Gjatë kësaj kohe ku gjenden aviatorët?
36. Me çfarë punësh merren aviatorët gjatë gadishmërisë Nr. 3?
37. Çë punë bëjnë aviatorët gjatë kësaj gadishmërie?

38. Ku mund të flejnë aviatorët gjatë kësaj gadishmërie?
39. Në cilën gadishmëri duhet të kalojnë aviatorët brenda një ore?
40. Çka duhet të jenë në gjendje të bëjnë aviatorët brenda një ore kudo qofshin?
41. Ku duhet të jenë pilotët gjatë gadishmërisë Nr. 2?
42. Në çfarë dhome duhet të jenë ata gjatë kësaj gadishmërie?
43. Me çka duhet të jenë të veshur pilotët gjatë gadishmërisë Nr. 2?
44. Çë duhet të bëjnë pilotët me kominoshen e pilotazhit gjatë gadishmërisë Nr. 2?
45. Nga ku duhet të nxiren aeroplanat gjatë kësaj kohe?
46. Aeroplanat duhet të nxiren nga hangarët dhe ku duhet të vihen gjatë gadishmërisë Nr. 2?
47. Ku duhet të vihen aeroplanat për të qenë gati për fluturim?
48. Zakonisht, sa minuta zgjat kjo periudhë?
49. Cila gadishmëri zgjat zakonisht 15 minuta?
50. Ku janë pilotët gjatë gadishmërisë Nr. 1?
51. Për çka e presin pilotët sinjalin në avionë?
52. Cilët e presin sinjalin në avionë për fluturim?
53. Çka presin pilotët për fluturim?
54. Në cilën gadishmëri e presin pilotët sinjalin për fluturim?
55. Për shkatërrimin e cilëve objektive janë të armatosur në ditët tona avionët ndjekës?
56. Me çka janë të armatosur në ditët tona avionët ndjekës?
57. Çfarë avionësh janë të armatosur në ditët tona me raketa?

58. Me çka i shkatërrojnë pilotët objektivet ajrorë?
59. Përveç avionëve ndjekës të armatosur me raketa, edhe çka tjetër përdoret për shkatërrimin e objekteve ajrorë?
60. Për çka përdoren misilet e telekomanduar?
61. Përveç misileve të telekomanduar, çka tjetër përdoret për shkatërrimin e objekteve ajrorë?
62. Sa lloje misilesh të telekomanduar ka?
63. Çë lloj misilesh janë ata që hudhen nga toka?
64. Po misilet që hudhen nga avioni, çë lloj misilesh janë?
65. Si i quajmë me një fjalë misilet që hudhen nga toka dhe ato që hudhen nga avioni?



## FJALOR

ekspert, -i (m.) ekspertë, -t	expert
gadishmëria Nr. 3	(the airplanes are in the hangar and the pilots at the airport)
identifikim, -i (m.)	identifying, identification
kominoshe, kominoshja kominoshe, -t (f.)	overalls; flight suit
për t'u-mbrojtur (v.) (unë mbröhem)	see "me u-mprojtë"
misil, -i (m.) misile, -t	missile
misil i telekomanduar	guided missile
misil që hudhet nga ajri	air to air missile
misil që hudhet nga toka	ground to air missile
për t'u-nxjerrë (v.) (unë nxirem)	to be taken out; to be pulled out; to be extracted; to be expelled, to be thrown out
Pararojat e Vëzhguesve Ajrorë	Reporting and Signal Outpost, Air Defense Observation, Air Reconnaissance
radar, -i (m.) radarë, -t	radar
radiolokator, -i (m.) radiolokatorë, -t	radiolocator, radar
shkatërrim, -i (m.) shkatërrime, -t	destruction, destroying, ruin
i, e, të shpërndarë të shpërndara (adj. m. & f.)	lead (out), dispersed, scattered

L. 116

të vëzhguar, -it  
(neuter)

observing, reconnoitering

SHËNIME

në të katër anët e vendit in every corner, all over the country

## Mësimi i 117-të

### RËNDËSIA E PARASHUTISTËVE

Taktika e një lufte moderne na mëson se trupat, për shkak të armëve bërthamore, duhet të jenë të shpërndara në një zonë të gjerë. Nga kjo taktikë e re kuptohet vetvetiu se rëndësinë më të madhe e kanë trupat e koracuara dhe trupat e parashutistëve, sepse vetëm këto trupa lëvizin shpejt, veçori kjo e domosdoshme në një luftë moderne. Trupat e koracuara dhe parashutistët kanë edhe dy veçori tjera të mira:

(a) mund të shfrytëzojnë me shpejtësi të madhe armët bërthamore;

(b) pësojnë më pak dëme nga sulmi atomik i armikut sepse mjetet e koracuara janë të veshura me pafta të trasha çeliku, kurse parashutistët për dy arsye tjera: para sulmit nuk janë të përqëndruar në masë gjëkund, dhe pas sulmit mund të largohen shpejt nga zonat e infektuara me radioaktivitet.

Për arsye të veçorive që u-përmendën më lart, rrjedh nevoja e një bashkëpunimi të ngushtë midis trupave të koracuara dhe parashutistëve.

Sot, një ndër detyrat kryesore të parashutistëve është

që të shkatërrojnë, aty ku parashikohet një sulm nga ana e ushtrisë së tyre, të gjitha mjetet me të cilat mund të hudhen predha atomike, si edhe aerodrome ose baza për hudhje misilesh të pajisur me kapsulla bërthamore.

Një tjetër detyrë e parashutistëve, gjithënjë në fazën e përgatitjes së sulmit, është që të blokojnë, ose së paku të vonojnë, dërgimin e trupave rezervë të armikut.

Të shumtën e herës bashkëpunimi i dy degëve të lartpërmendura bëhet i domosdoshëm veçanërisht kur është e nevojshme që t'i priten armikut rrugët e zbrapjes, kështu që pastaj të rrethohet.

Aksioni i parashutistëve, sipas nevojave që ka ushtria, mund të fillojë njëkohësisht me aksionin e trupave të koracuara, para ose pas tij. Në qoftë se faktori "befasi" është elementi kryesor i sulmit, atëherë parashutistët hyjnë në veprim të parët, gjatë natës ose në të gdhirë.

Duhet pasur parasysh, gjithashtu, se trupat e parashutistëve nuk kanë artileri të tyre, prandaj ato duhet të jenë të ndihmuara nga aviacioni, i cili duhet të dërmojë artilerinë e armikut sapo të fillojë sulmi.

## PYETJE

1. Taktika e çfarë lufte na mëson se trupat duhet të jenë të shpërndara në një zonë të gjerë?
2. Çë na mëson taktika e një lufte moderne?
3. Pse duhet të jenë të shpërndara trupat në një zonë të gjerë?
4. Çfarë rëndësie kanë trupat e koracuara dhe trupat e parashutistëve në një luftë moderne?
5. Çë kuptohet vetvetiu nga kjo taktikë e re e një lufte moderne?
6. Cilat trupa kanë rëndësinë më të madhe në këtë taktikë të re?
7. Cilat trupa mund të lëvizin shpejt?
8. Cila është veçoria e domosdoshme e trupave të koracuara dhe e trupave të parashutistëve në një luftë moderne?
9. Cila veçori është e domosdoshme në një luftë moderne?
10. Sa veçori tjera të mira kanë trupat e koracuara e parashutistët?
11. Me çfarë shpejtësie mund t'i shfrytëzojnë ato trupa armët bërthamore?
12. Cilat armë mund të shfrytëzojnë me shpejtësi të madhe trupat e koracuara dhe trupat e parashutistëve?
13. Në krahasim me këmbësinë, sa dëme pësojnë trupat e koracuara dhe parashutistët?
14. Nga sulmi atomik i kujt pësojnë pak dëme trupat e koracuara dhe parashutistët?
15. Me çfarë paftash janë të veshura mjetet e koracuara?
16. Çfarë metali është ai, prej të cilit janë të bëra paftat e mjeteve të koracuara?

17. Çfarë arsyesh tjera të mira kanë parashutistët?
18. Cilët nuk janë të përqëndruar në masë gjëkundi para sulmit?
19. Ku nuk janë të përqëndruar parashutistët në masë para sulmit?
20. Si mund të largohen parashutistët nga zonat e infektuara me radioaktivitet?
21. Çë mund të bëjnë parashutistët shpejt pas sulmit?
22. Nga cilat zona mund të largohen parashutistët me shpejtësi pas sulmit?
23. Kur mund të largohen parashutistët nga zonat e infektuara me radioaktivitet?
24. Me çka janë të infektuara zonat prej të cilave largohen parashutistët shpejt pas sulmit?
25. Kështu, a rrjedh nevoja e një bashkëpunimi të ngushtë midis trupave të koracuara dhe të parashutistëve?
26. Për arsye të veçorive që u-përmendën më lart, në mes cilave trupa rrjedh nevoja e një bashkëpunimi të ngushtë?
27. Çfarë nevoje rrjedh për arsye të veçorive që u-përmendën më lart?
28. Detyra kryesore e kujt është sot që të shkatërrojnë të gjitha mjetet me të cilat mund të hudhen predha atomike?
29. Çka duhet t'u bëjnë parashutistët të gjitha mjeteve me të cilat mund të hudhen predha atomike?
30. Kush duhet t'i shkatërrojë të gjitha mjetet me të cilat hudhen predha atomike aty ku parashikohet një sulm nga ana e ushtrisë së tyre?
31. Në çë vend duhet t'i shkatërrojnë parashutistët të gjitha mjetet me të cilat mund të hudhen predha atomike?
32. Po aerodromeve dhe bazave për hudhje misilesh, çë duhet t'u bëjnë parashutistët?

33. Cilët duhet t'i shkatërrojnë gjithashtu edhe aerodromet ose bazat për hudhje misilesh të pajisura me kapsulla bërthamore?
34. Me se janë të pajisura misilet që duhet të shkatërrojnë parashutistët?
35. Cilët duhet t'a blokojnë ose t'a vonojnë dërgimin e trupave rezervë të armikut?
36. Detyra e kujt është kjo punë?
37. Çë duhet të bëjnë parashutistët gjithënjë në fazën e përgatitjes së sulmit?
38. Kur bëhet i domosdoshëm bashkëpunimi i dy degëve të lartpërmendura?
39. Çë bëhet veçanërisht i domosdoshëm kur është e nevojshme që t'i priten armikut rrugët e zbrapjes?
40. Kujt duhet t'i priten rrugët e zbrapjes?
41. Kujt duhet t'i priten rrugët e zbrapjes për t'a rrethuar pastaj?
42. Pse i priten armikut rrugët e zbrapjes?
43. Aksioni i cilave trupa mund të fillojë njëkohësisht me aksionin e trupave të koracuara?
44. Sipas nevojave që ka ushtria, qysh mund të fillojë aksioni i parashutistëve dhe i trupave të koracuara?
45. Cili aksion mund të fillojë njëkohësisht, para ose pas aksionit të trupave të koracuara?
46. Kur mund të fillojë aksioni i parashutistëve?
47. Cilët hyjnë në veprim të parët, në se faktori "befasi" është elementi kryesor i sulmit?
48. Çë bëjnë parashutistët në qoftë se faktori "befasi" është elementi kryesor i sulmit?
49. Çë bëjnë parashutistët gjatë natës ose në të gdhirë?

L. 117

50. Elementi kryesor i cilit aksion është nganjëherë faktori "befasi"?
51. Cilat trupa s'kanë artileri të tyre?
52. Çë duhet pasur, gjithashtu, parasysh përsa u përket parashutistëve?
53. Çfarë trupash duhet të ndihmohen nga aviacioni?
54. Artilerinë e kujt duhet t'a dërmojë aviacioni sapo të fillojë sulmi?
55. Kur duhet t'a dërmojë aviacioni artilerinë e armikut?
56. Artilerinë e kujt duhet t'a dërmojë aviacioni sapo të fillojë sulmi?



## FJA: DR

ahere (adv.)	see "atëherë"
atomik, -e (adj. m. & f.)	atomic
bërthamor, -e (adj. m. & f.)	nuclear
për të bllokuar (v.) (unë blokoj)	to block
çelik, -u (m.)	steel
dërgim, -i (m.) dërgime, -t	sending
gjëkund (adv.)	anywhere; somewhere
huhje, -a (f.)	launching, throwing
i, e, të infektuar të infektuara (adj. m. & f.)	infected
kapsullë bërthamore	nuclear warhead
i, e, të lartpërmendur të lartpërmendura (adj. m. & f.)	above-mentioned
paftë, -a (f.) pafta, -t	armor, plate
për t'u-parashikuar (v.) (parashikohet)	to be foreseen; to be forecast
përgatitje, -a (f.) përgatitje, -t	preparation
radioaktivitet, -i (m.)	radioactivity
rezervë, -a (f.) rezerva, -t	reserve; spare

L. 117

për të shfrytëzuar (v.)  
(unë shfrytëzoj)

to take advantage of; to exploit;  
to utilize

veçori, -a (f.)  
veçori, -të

characteristic

vetvetiu (adv.)

by itself, automatically

për të vonuar (v.)  
(unë vonoj)

to delay

#### SHËNIME

kuptohet vetvetiu

it's self-understood

duhet pasur parasysh

it should be taken into consideration

Mësimi i 118-të

### TË HETUARIT E NJË AKSIDENTI AJROR

Dje komandanti i aeroportit ushtarak më thërriti në zyrën e tij dhe më caktoi të bëj hetimet e një aksidenti. Parëmbremë Nëntoger Jakup Belushka me reaktivin ndjekës-gjuajtës 801 do të vente për një mision vëzhgimi dhe u-mundua të ngrihej nga pista, por nuk e bëri dot dhe vajti e u-përplas në godinën Nr. 4 të aeroportit. Avioni pothuajse u-shkatërrua fare, kurse Nëntoger Belushka humbi jetën:

Posa vajta në vendin e ngjarjes fillova të shikoj për ndonjë indic. U-futa në kabinën e shkatërruar të pilotit e u hodha një sy sahatëve të kontrollit; të tërë ishin aty, përpara meje: sahati i kilometrazhit, sahati i shpejtësisë së erës, takometri, sahati i presionit të karburantit e të vajit, sahati që shënon ngjitjen në metra për minut etj. "A punojnë vallë?" thash me vete dhe pa i dhënë përgjegje pyetjes sime, u-ktheva nga e majta dhe u-mbështeta në timon, i cili ish shtrembëruar. U-mundova të shtyja levën e gazit, por ajo s'luante nga vendi. Shtyra levën e sistemit të rrotave, por rrotat e reaktivit kush e di se ku kishin mbaruar. Tërhoqa dorëzën e frenave, por ajo më ngeli në dorë: ish thyer. Shtypa disa susta e ktheva disa

L. 118

çelësa, por asgjë nuk punonte. Në konditat që ndodhej reaktivi nuk e di në se do të jem i zoti të gjej arësyen e aksidentit. Piloti kish qenë në kontakt me radio me vend-komandën gjer në momentin e aksidentit dhe kish lajmëruar se çdo gjë ish në rregull. Ç'kish ndodhur vallë në avion që shkaktoi aksidentin? Qe faji i pilotit apo i mekanizmit të avionit? Këtë përgjegje kërkon komandanti nga unë.

## PYETJE

1. Kur më thërriti në zyrën e tij komandanti i aeroportit ushtarak?
2. Kush më thërriti dje në zyrën e tij?
3. Ç'bëri dje komandanti i aeroportit ushtarak?
4. Kush më caktoi të bëj hetimet e një aksidenti?
5. Ç'më caktoi të bëj komandanti i aeroportit ushtarak?
6. Kur do të vente Nëntoger Belushka për një mision vëzhgimi?
7. Kush do të vente parëmbërëmë me reaktivin ndjekës-gjuajtës 801, për një mision vëzhgimi?
8. Ç'do të bënte parëmbërëmë Nëntoger Jakup Belushka me reaktivin ndjekës-gjuajtës 801?
9. A u-ngrit nga pista reaktivi?
10. Ç'i ngjau Nëntogerit ndërsa po mendohej të ngrihej nga pista me reaktivin e tij?
11. Kush vajti e u-përplas në godinën Nr. 4 të aeroportit?
12. Në cilën godinë vajti e u-përplas Nëntoger Belushka me reaktivin e tij?
13. Ç'u-shkatërrua pothuejse fare?
14. Ç'i ngjau avionit?
15. Kush humbi jetën?
16. Ç'i ngjau Nëntoger Belushkës?
17. Ku vajta dhe fillova të shikoj për ndonjë indic?
18. Ç'bëra posa vajta në vendin e ngjarjes?
19. Për se fillova të shikoj posa vajta në vendin e ngjarjes?
20. Kush u-fut në kabinën e shkatërruar të pilotit?

21. Ku u-futa e u hodha një sy sahatëve të kontrollit?
22. Ç'bëra në kabinën e shkatërruar të pilotit?
23. Cilët sahatë ishin aty, përpara meje?
24. A ishin në kabinën e pilotit sahati i kilometrazhit, sahati i shpejtësisë së erës dhe takometri?
25. Cilët sahatë ishin në kabinën e pilotit?
26. Po sahati i presionit të karburantit e të vajit, ku ishte?
27. Ku ishte sahati që shënon ngjitjen në metra për minut?
28. Kush tha me vete: "A punojnë vallë?"
29. Ç'thash me vete?
30. Dhe ç'bëra pa i dhënë përgjegje pyetjes sime?
31. Nga u-ktheva pa i dhënë përgjegje pyetjes sime?
32. Kush u-mbështet në timon, që ish shtrembëruar?
33. Ku u-mbështeta?
34. Kush u-mundua të shtynte leven e gazit, por ajo s'luante nga vendi?
35. Ç'u-mundova të bëja?
36. Kush shtyri leven e sistemit të rrotave?
37. Cilën levë shtyra?
38. A ishin aty rrotat e reaktivit?
39. Ku ishin rrotat e reaktivit?
40. Kush tërhoqi dorëzën e frenave, por ajo ish thyer?
41. A më ngeli në dorë sepse ish thyer?
42. Çë ngjau kur tërhoqa dorëzën e frenave?

43. Cili shtypi disa susta e ktheu disa çelësa, por asgjë nuk punonte?
44. Çfarë shtypa e çfarë ktheva, por asgjë nuk punonte?
45. Kush nuk e di në se do të jetë i zoti, në konditat që ndodhej reaktivi, të gjejë arësyen e aksidentit?
46. Ç'nuk do të jem i zoti të bëj, në konditat që ndodhej reaktivi?
47. Kush kish qenë në kontakt me radio me vend-komandën gjer në momentin e aksidentit?
48. Me cilin vend kish qenë piloti në kontakt me radio gjer në momentin e aksidentit?
49. Cili kish lajmëruar se çdo gjë ish në rregull?
50. Ç'kish bërë piloti?
51. A e di unë ç'kish ndodhur në avion që shkaktoi aksidentin?
52. A duhet t'i përgjigjem unë kësaj pyetje?
53. A qe faji i pilotit apo i mekanizmit të avionit?
54. Kush nuk e di në se qe faji i pilotit apo i mekanizmit të avionit?
55. Cilën përgjegje kërkon komandanti nga unë?
56. Kush kërkon të dijë se i kujt ka qenë faji: i pilotit apo i mekanizmit t'avionit?
57. Ç'kërkon komandanti nga unë?

## FJALOR

dorëza e frenave	brake handle
frena, -t (f. pl.)	brakes
të hetuar, -it (neuter)	investigation, investigating
indic, -i (m.) indice, -t	clue
levë, -a (f.) leva, -t	lever
leva e gazit	throttle lever
leva e sistemit të rrotave	landing gear control lever
për t'u-mbështetur (v.) (unë mbështetem)	to lean (against); to base; to rely
moment, -i (m.) momente, -t	moment
ndjekës-gjuajtës (m.)	interceptor (airplane)
për të ngelur (v.) (unë ngel)	to get stuck; to remain (behind); to flunk (an examination)
ngjitje, -a (f.)	climb, ascent, rise; adhesion
parëmbërme (adv.)	the night before last
presion, -i (m.) presione, -t	pressure
rrotë, -a (f.) rrota, -t	wheel
sahati i kilometrahit	speed indicator
sahat kontrolli	indicator, meter, dial



sahati i presionit të karburantit e të vajit	fuel and oil pressure indicator
sahati që shënon ngjitjen në metra për minut	rate of climb indicator
sahati i shpejtësisë së erës	wind velocity indicator
i, e, të shkatërruar të shkatërruara (adj. m. & f.)	destroyed, ruined
për t'u-shtrembëruar (v.) (shtrembërohet)	to be twisted, to be distorted
takometër, takometri (m.) takometra, -t	tachometer

## SHËNIME

nuk e bëri dot

he couldn't make it; he didn't make it

më ngeli në dorë

it got stuck in my hand; I got stuck  
with it

Mësimi i 119-të

### ZBRITJE E RREZIKSHME

Kulla e komandimit u-drodh. Një raketë e kuqe u-vërvit që andej dhe flakëroi në qiell. Zëvendës komandanti u-ngjit menjëherë lart dhe mbërtheu fort në duar mikrofonin.

--Kush raportoi? Kush raportoi për shuarjen në gjashtëmijë?

Shikonte duke rrotulluar kokën nga të katër anët, por nuk dukej gjë, vetëm kreshtat e maleve....

--Këtu shtatëmbëdhjeta; m'u-fik turbina; lartësia pesëmijë e pesëqind.

--Ashtu?; drejtohu për në aerodrom; bëj edhe një provë të lëshosh turbinën në ajr; ku ndodhesh?

Vetëm atëhere piloti u-kujtua të hidhte sytë përreth: male, lumë, tutje para syve i del aerodromi.... Aeroplani rrëshqet drejt atje.

--Katapultë...--i erdhi zëri nënkokoren e lëkurtë--hidhu më parashutë.... Ç'pret!.... Të thash që në fillim, hidhu!

Aeroplani vazhdonte të rrëshqiste tatëpjetë. Në kabinë

heshtje e shurdhër. Zëri në kokoren e lëkurtë nuk vinte më... u-shkarkuan bateritë. Malet afroheshin, ngjiteshin lart. Në ndenjësën e reaktivit piloti si shkëmb kish zënë vend, s'tundej; kishte vendosur t'a zbriste në fushë atë turbinë të ftohët.

Udhëheqësi fliste pareshtur. Nuk besonte se piloti s'e dëgjonte më, që prej kohe.

Piloti e kthen aeroplanin në krah. Bën rrëshqitje të shpejtuar tatëpjetë. --Jam lart--mendon--mos kaloj aerodromin. Rrëshqitje, rrotullohet përsëri majtas. Aerodromi u-çpalos tej e tej para syve të tij, dukej si qilim i butë i gjelbër, rreth e qark me male që prisnin në heshtje....

--Shumë mirë që u-drejtove në bar larg nga bredhja e ngritjes. Mos e rrit shpejtësinë.... Nxire...nxire.... Mbaje. Shumë mirë....

Udhëheqësi la mikrofonin mënjanë dhe doli nga kulla.

Aeroplani rrëshqiti me të shpejtë mbi bar dhe mbeti. Kabina u-hap; nga larg u-duk trupi i gjatë e i hollë i pilotit që u-ngrit dhe pastaj këceu përdhe. Tokë!

Shokët pilotë që ndiqnin me ankth fluturimin e tij u-vërsulën drejt tij me brohoritje gëzimi.

PYETJE

1. Cila kullë u-drodh?
2. Ç'i ngjau kullës së komandimit?
3. Çfarë rakete u-vërvit që andej?
4. Ç'bëri një raketë e kuqe?
5. Ç'flakëroi në qiell?
6. Ku flakëroi raketa e kuqe?
7. Ku u-ngjit menjëherë zëvendës komandanti?
8. Kush u-ngjit menjëherë lart?
9. Ç'mbërtheu fort në duar?
10. Ku e mbërtheu fort mikrofonin?
11. Kush thirri: "Kush raportoi për shuarjen në gjashtëmijë?"
12. Ç'pyeti në mikrofon zëvendës komandanti?
13. Kush shikonte duke rrotulluar kokën nga të katër anët?
14. Ç'bënte zëvendës komandanti?
15. Ku nuk dukej gjë, vetëm kreshtat e maleve....?
16. Ku u-dëgjua: "Këtu shtatëmbëdhjeta; m'u-fik turbina; lartësia pesëmijë e pesëqind"?
17. Ç'u-dëgjua në kullën e komandimit?
18. Kush u-përgjegj: "Drejtohu për në aerodrom"?
19. Ç'u-përgjegj zëvendës komandanti?
20. Kush i tha pilotit: "Bëj edhe një provë të lëshosh turbinën në ajr; ku ndodhesh?"
21. Ç'e pyeti zëvendës komandanti pilotin?

22. Kush u-kujtua të hidhte sytë përreth?
23. Ç'bëri piloti?
24. Kush pa male, një lumë dhe më tutje aerodromin?
25. Ç'pa piloti kur u-kujtua të hidhte sytë përreth?
26. Ç'rrëshqet drejt aerodromit?
27. Ç'bën aeroplani me turbinë të shuar?
28. Ku u-dëgjua: "Katapultë...hidhu me parashutë...ç'pret"?
29. Ç'dëgjoi piloti në kokoren e lëkurtë?
30. Kush dëgjoi në kokoren e lëkurtë: "Katapultë...hidhu me parashutë...ç'pret"?
31. Qysh vazhdonte të rrëshqiste aeroplani?
32. Ç'vazhdonte të rrëshqiste tatëpjetë?
33. Ku ishte heshtja e shurdhër?
34. Çfarë heshtje ishte në kabinë?
35. Ç'nuk vinte më në kokoren e lëkurtë?
36. Ku nuk vinte më zëri?
37. Ç'u ngjau baterive?
38. Ç'u-shkarkua?
39. Ç'afroheshin, ngjiteshin lart?
40. Ç'bënin malet?
41. Kush kish zënë vend si shkëmb në ndenjësën e reaktivit?
42. Ku kish zënë vend piloti si shkëmb?
43. Kush kish vendosur t'a zbriste në fushë atë turbinë të ftohët?

44. Ç'kish vendosur të bënte piloti?
45. Ç'bënte udhëheqësi?
46. Kush fliste pareshtur?
47. Ç'nuk besonte?
48. Kush nuk besonte se piloti s'e dëgjonte më, që prej kohe?
49. Qysh e ktheu piloti aeroplanin?
50. Kush e ktheu aeroplanin në krah?
51. Në ç'drejtim bën piloti rrëshqitje të shpejtuara?
52. Çfarë rrëshqitjesh bën ai tatëpjetë?
53. Kush mendon: "Jam lart, mos kaloj aerodromin"?
54. Ç'mendon piloti?
55. Kush bën rrëshqitje, rrotullohet përsëri majtas?
56. Ç'bën piloti?
57. Ç'u-çpalos tej e tej para syve të tij?
58. Ku u-çpalos aerodromi?
59. Ç'dukej si qilim i gjelbër, rreth e qark me male që prisnin në heshtje?
60. Qysh dukej aerodromi?
61. Kush thonte: "Shumë mirë...nxire...mbaje"?
62. Ç'thonte udhëheqësi?
63. Kush e la mikrofonin mënjanë dhe doli nga kulla?
64. Ç'bëri udhëheqësi dhe doli nga kulla?
65. Ç'rrëshqiti me të shpejtë mbi bar dhe mbeti?
66. Ç'bëri reaktiv mbi bar dhe mbeti?

67. Ku rrëshqiti dhe ku mbeti reaktivi?
68. Ç'u-hap dhe nga larg u-duk trupi i gjatë e i nollë i pilotit?
69. Ç'u-duk pasi u-hap kabina?
70. Kush u-ngrit dhe pastaj këceu përdhe?
71. Ç'bëri piloti?
72. Cilët ndiqnin me ankth fluturimin e tij?
73. Qysh e ndiqnin pilotët fluturimin e shokut të tyre?
74. Në drejtim të kujt u-vërsulën me brohoritje gëzimi?
75. Ç'bënë pilotët me brohoritje gëzimi?

## FJALOR

ankth, -i (m.)	anxiety; nightmare (Med.)
brohoritje, -t (f. pl.)	see "brohori"
për t'u-çpalosur (v.) (çpaloset)	to be unfolded
për t'u-fikur (v.) (unë fikem)	to die (for an engine or motor); to be turned off, extinguished, put out; to be ruined
për të flakëruar (v.) (unë flakëroj)	to shine
katapultë, -a (f.) katapulta, -t	catapult; ejection seat
kokore, kokorja (f.) kokore, -t	crash or safety helmet
kreshtë, -a (f.) kreshta, -t	crest
i, e, të lëkurtë të lëkurta (adj. m. & f.)	made of leather, leathern
mënjë (adv.)	aside
mikrofon, -i (m.) mikrofona, -t	microphone
ndenjëse, ndenjësja (f.) ndenjëse, -t	seat
pareshur (adv.)	continuously
rreth e qark (adv. & prep.)	see "rreth e përqark"
rrëshqitje (f.)	slip, slide, glide; skating



për të rrotulluar (v.) (unë rrotulloj)	to turn; to revolve
për t'u-rrotulluar (v.) (unë rrotullohem)	to turn around (oneself); to be revolved; to be spun
shkëmb, -i (m.) shkëmbinj, -të	rock, cliff, boulder
i, e, të shpejtuar të shpejtua (adj. m. & f.)	accelerated, accelerating
i, e, të shuar të shuara (adj. m. & f.)	dead (for an engine); extinguished; erased
shuarje, -a (f.)	stopping (of an engine); extinction; erasure
i, e, të shurdhër të shurdhëra (adj. m. & f.)	see "i shurdhët"
tatëpjetë (adv.)	downhill, down the hill, downwards
tej e tej (adv.)	right through; through
për t'u-tundur (v.) (unë tundem)	to move from one's seat; to be shaken; to be rocked
turbinë, -a (f.) turbina, -t	turbine
tutje (adv. & prep.)	farther, further; beyond
udhëheqës, -i (m.) udhëheqës, -it	leader; air controller; ground controller; air traffic controller
për t'u-vërsulur (v.) (unë vërsulem)	to hurl oneself; to dash; to attack
për t'u-vërvitur (v.) (unë vërvitem)	to dash; to dart; to attack

zëvendës, -i (m.)  
zëvendës, -it

acting; deputy

SHËNIME

për t. bërë provë  
(unë bë provë)

to try

brethja e ngritjes

the active runway

kullë komandimi

control tower

Mësimi i 120-të

### NJË MBRËMJE NË PORTIN USHTARAK

Atë mbrëmje porti ushtarak ishte i qetë. Anijet e flotës luftarako-detare ishin të akostuara pranë bankinave dhe e vetmja shenjë gjallërie ishin rojet mbi kuvertat e anijeve.

Papritmas u-dëgjua në dhomën e dezhurnit sirena e alarmit. Menjëherë u-panë duke dalur me vrap nga ndërtesa 7-8 detarë, të cilët rendën drejt një bankine dhe u-hodhën në dy katera. Nuk kaloi shumë kohë dhe u-dëgjua gumëzhima e motorëve. Në këtë ndërkohë dy motobarka me personel ushtarako-detar u-akostuan. Duket se vinin nga një zonë tjetër e portit. Të gjithë u-shpërndanë nëpër anijet dhe zunë postet luftarake.

S'kishin kaluar më shumë se dhjetë minuta nga çasti që buçiti sirena e alarmit dhe tani katerat filluan të çajnë ujërat e detit Adriatik. Dritat e qytetit filluan të zhduken, ndërsa llamburisnin, diku larg, vetëm dritat e fshatrave rreth e qark. Detarët qëndronin në postet e tyre duke vrojtuar detin, tokën, qiellin.

Mjetet lundruese dalngadalë filluan të humbisnin qetësinë. Dallgët filluan të ngrihen përpjetë si bregore të larta. Anijet

një herë ngriheshi mbi kreshten e dallgëve dhe një herë tjetër uleshin. Ndonjë valë e rrëmbyer përplasej mbi bord gjithë shkumbë dhe shpërndahej mbi kuvertë.

Në anijen në krye buçiti i fuqishëm zëri i sinjalistit:

--Objekt në drejtim të kësaj!

Menjëherë dy projektorë lëshuan dritat e tyre të fuqishme mbi sipërfaqen e detit dhe pas pak sekondash që të dyja këto drita u-përqëndruan mbi objektin e errët....

Edhe një herë u-dëgjua zëri i sinjalistit:

--Anija e panjohur nuk i përgjigjet thirrjes!

Në pak çaste tri katerat siluruese e kishin rrethuar anijen dhe në katerën 712 kumboi urdhëri:

--Akosto anijen nga e majta dhe gati të hidhemi në bord të saj!

\* \* \* \* \*

Mëngjes heret. Rrezet e diellit kanë rënë mbi sipërfaqen e detit të qetë. Tri katera po hynin në port dhe njera kish rimorkiuar peshkatoren që kish këputur cimat dhe valët e kishin hedhur në det të hapët.

## PYETJE

1. Qysh ishte atë mbrëmje porti ushtarak?
2. Cili port ishte i qetë atë mbrëmje?
3. Ku ishin të akostuara anijet e flotës luftarako-detare?
4. Ç'bënin anijet e flotës luftarako-detare pranë bankirave?
5. Ç'ishte e vetmja shenjë gjallërie?
6. Ç'ishin rojet mbi kuvertat e anijeve?
7. Në ç'vend u-dëgjua papritmas sirena e alarmit?
8. Ç'ngjau papritmas në dhomën e dezurnit?
9. Sa detarë u-panë duke dalur me vrap menjëherë nga ndërtesa?
10. Prej nga u-panë duke dalur menjëherë me vrap 7-8 detarë?
11. Cilët rendën drejt një bankine?
12. Ç'bënë 7-8 detarët menjëherë?
13. Cilët u-hodhën në dy katera?
14. Ku u-hodhën detarët?
15. Nuk kaloi shumë kohë dhe ç'u-dëgjua?
16. Kur u-dëgjua gumëzhima e motorëve?
17. Sa motobarka me personel ushtarako-detar u-akostuan në këtë ndërkohë?
18. Ç'ngjau në këtë ndërkohë?
19. Prej nga duket se vinin?
20. Cilët duket se vinin nga një zonë tjetër e portit?
21. Cilët u-shpërndanë nëpër anije?
22. Ku u-shpërndanë të gjithë dhe zunë postet luftarake?

23. Cilat mjete filluan të çajné ujrat e detit Adriatik?
24. Sa minuta kishin kaluar nga çasti që buçiti sirena e alarmit?
25. Cilat drita filluan të zhduken?
26. Ç'filluan të bëjnë dritat e qytetit?
27. Ku llamburisnin vetëm dritat e fshatrave rreth e qark?
28. Cilat drita llamburisnin diku larg?
29. Ku qëndronin detarët duke vrojtuar detin, tokën, qiellin?
30. Cilët qëndronin në postet e tyre duke vrojtuar detin, tokën, qiellin?
31. Kur filluan mjetet lundruese të humbisnin qetësinë?
32. Ç'filluan të humbisnin dalngadalë mjetet lundruese?
33. Cilat filluan të ngrihen përpjetë si bregore të larta?
34. Qysb filluan të ngrihen përpjetë dallgët?
35. Cilat një herë ngriheshin mbi kreshtën e dallgëve dhe një herë tjetër uleshin?
36. Ç'bënin anijet një herë dhe ç'bënin një herë tjetër?
37. Ku përplasej ndonjë valë e rrëmbyer?
38. Ç'bënte ndonjë valë e rrëmbyer mbi bord?
39. Ku shpërndahej pastaj gjithë shkumë?
40. Ç'bënte pastaj mbi kuvertë?
41. Në cilën anije buçiti i fuqishëm zëri i sinjalistit?
42. Ç'buçiti i fuqishëm në anijen në krye?
43. Ku buçiti zëri i sinjalistit: "Objekt në drejtim të kështjës"?
44. Kur lëshuan dritat e tyre të fuqishme dy projektorë?

45. Sa projektorë lëshuan menjëherë dritat e tyre të fuqishme mbi sipërfaqen e detit?
46. Ku lëshuan dritat e tyre të fuqishme dy projektorë?
47. Pas sa sekondash që të dyja dritat u-përqëndruan mbi objektin e errët?
48. Ku u-përqëndruan që të dyja dritat pas pak sekondash?
49. Zëri i kujt u-dëgjua edhe një herë: "Anija e panjohur nuk i përgjigjet thirrjes"?
50. Kur u-dëgjua zëri i sinjalistit: "Anija e panjohur nuk i përgjigjet thirrjes"?
51. Ç'u-dëgjua edhe një herë?
52. Cilat mjete lundruese në pak çaste e kishin rrethuar anijen?
53. Ç'bënë në pak çaste tri katerat siluruese?
54. Në cilën katerë kumboi urdhëri: "Akosto anijen nga e majta dhe gati të hidhemi në bord të saj"?
55. Ç'urdhër kumboi në katerën 712?
56. Ç'kumboi në katerën 712?
57. A është mëngjes heret dhe rrezet e diellit kanë rënë mbi sipërfaqen e detit të qetë?
58. Ç'kohë e ditës është dhe rrezet e diellit kanë rënë mbi sipërfaqen e detit të qetë?
59. Sa katera po hynin në port?
60. Ku po hynin tri katera?
61. Ç'kish rimorkiuar njera prej tyre?
62. Cila anije kish rimorkiuar peshkatoren?
63. Ç'i kish ngjarë peshkatores?

L. 120

64. Cila anije kish këputur cimat?
65. Ç'kish këputur peshkatorja dhe valët e kishin hedhur në det të hapët?
66. Ku e kishin hedhur valët peshkatorën, pasi kish këputur cimat?



## FJALOR

për të akostuar (v.) (unë akostoj)	to dock; to approach (for ships)
për t'u-akostuar (v.) (akostohet)	to dock; to be docked
i, e, të akostuar të akostuara (adj. m. & f.)	docked; anchored
bankinë, -a (f.) bankina, -t	dock
bord, -i (m.)	board
në bord (adv.)	aboard (for ships and airplanes only)
për të buçitur (v.) (unë buças)	to shrill; to roar; to resound
cimë, -a (f.) cima, -t	rope
gumëzhimë, -a (f.) gumëzhima, -t	roar
i, e, të hapët të hapëta (adj. m. & f.)	open, expanded; spread out; light (for colors)
kiç, -i (m.) kiça, -t	stern
lundruës, -e (adj. m. & f.)	floating, navigating
për të llamburitur (v.) (llamburit)	to shine
motobarkë, -a (f.) motobarka, -t	motorboat

peshkatore, peshkatorja peshkatore, -t (f.)	fishing boat
përpjetë (adv.)	upwards, uphill, up the hill
post, -i (m.) poste, -t	position; high office position; throne
projektor, -i (m.) projektorë, -t	searchlight
për të rimorkiuar (v.) (unë rimorkioj)	to tow
i, e, të rrëmbyer të rrëmbyera (adj. m. & f.)	see "i rrëmbyeshëm"
sekondë, -a (f.) sekonda, -t	second
sinjalist, -i (m.) sinjalistë, -t	signalman
sirenë, -a (f.) sirena, -t	siren
për të vrojtuar (v.) (unë vrojtoj)	to watch; to observe

SHËNIME

dhomë deziurni	quarter deck watch room; CQ (officer in charge of quarters)
----------------	--